



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr.822 Prot

Tiranë, më 26/4/2023

**REKOMANDIM**

**Nr.25, datë26/4/2023**

**PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS  
SË AUTORITETIT PUBLIK QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E RRJETIT  
AKADEMIK SHQIPTAR**

Në mbështetje të neneve 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: <https://www.rash.al/sq/>, të Autoritetit Publik/ Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (në vijim “Autoriteti Publik”).

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (në vijim “LDI”), kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”.

Në zbatim të gërmës “c”, pika 2 e nenit 4, nenit 5 dhe 6 të LDI, Zyra e Komisionerit ka miratuar Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të tij me informacion dhe dokumentacion publik.

Autoriteti Publik ka detyrimin të vendosë në zbatim programin institucional të transparencës, sipas Urdhrit nr.187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë.

Nisur nga rëndësia që paraqet arsimit, Zyra e Komisionerit ka vendosur në fokus të punës së saj për vitin 2023, monitorimin e transparencës proaktive të Autoriteteve Publike në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Përpos parashikimeve të LDI, transparenca e Autoritetit Publik ushtrohet edhe në respektim të detyrimeve ligjore të parashikuara në legjislacionin e posaçëm për arsimin e lartë, veçanërisht në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimin nr.781, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”.

Nga monitorimi i kryer në menunë e faqes zyrtare <https://www.rash.al/sq/rreth-nesh/programi-i-transparences/>, në ikonën “Rreth nesh”, Autoriteti Publik ka publikuar “Programin e Transparencës”. Specifikisht, është publikuar informacion vetëm për koordinatorin për të drejtën e informimit, (emër/mbiemër, e-mail, adresa, orari), si dhe regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, i cili nuk është i përditësuar.

Bazuar në monitorimin e kryer, Zyra e Komisionerit konstaton mosvënien në zbatim të Programit të Transparencës, në përputhje me pikën 1 të nenit 7 të LDI, urdhit nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të ndryshuar të Komisionerit.

Gjithashtu, sa i takon detyrimeve për garantimin e transparencës në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, bazuar në pikën 1 të vendimit nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”, Autoriteti Publik (RASH) publikon të dhëna dhe informacione, në kuadër të programit të transparencës dhe të trajtimit të ankesave ndaj institucioneve të arsimit të lartë.

Zyra e komisionerit konstaton se një pjesë e detyrimeve të këtij vendimi janë publikuar në link-un: <https://u-transparenca.al/>, por nga ana tjetër vërejmë se ky informacion nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës së Autoritetit Publik, si dhe nuk është përditësuar.

Konkretisht rezultojnë mangësi në rubrikat e mëposhtme:

### **Rreth autoritetit:**

- Struktura organizative
- Organigrama,
- Struktura e pagave,
- FunkSIONET dhe detyrat e AP,
- CV-të dhe pagat e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre dhe procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime.
- CV e pedagogëve të përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë, (bazuar në vendimin nr 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë).
- Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e RASH (përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve).
- Mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe paraqitjen e ankesave që lidhen me veprimet ose mosveprimet e drejtuesve/organeve drejtuese të institucionit të arsimit të lartë, (bazuar në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë).

### **Kuadri ligjor rregullator**

- Legjislacion ndërkombëtar
- Legjislacion kombëtar
- Akte nënligjore
- Rregullore
- Kodi i sjelljes
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit,
- Strategji
- Raport vjetor
- Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun.
- Marrëveshjet dy apo shumëpalëshe në nivel IAL-je dhe institucione të tjera, përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori) (bazuar në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”).

### **E drejta për tu informuar**

- Nr. i gjelbër
- Tel
- Format kërkesë/Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)

- Format ankese/Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)

### **Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP**

- Rezolute Kuvendi (nese ka)
- Planet strategjike të punës
- Raporte monitorimi/auditimi të KLSH-së
- Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës

### **Informacion mbi buxhetin dhe të dhëna financiare të autoritetit publik**

- Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara (sipas viteve) i RASH
- Të dhëna mbi buxhetin afatmesëm (PBA), buxhetin vjetor, grantin nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e tjera, të gjitha shpenzimet operative, shpenzimet për kërkim shkencor dhe shpenzimet kapitale të cdo instituconi publik të arsimit të lartë, përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori) (bazuar në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”).
- Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset (sipas viteve)
- Donacione, sponsorizime (sipas viteve)
- Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara

### **Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncensionit/partneritetit publik privat**

- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik i RASH
- Informacion mbi monitorimin e kontratave
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i RASH i përditësuar
- Informacion për procedurat e prokurimit publik (parashikim/realizim) apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori) (bazuar në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”).

### **Shërbimet që ofrohen nga AP**

- Tarifat përkatëse
- Formular aplikimi
- Afati kohor
- Procedura aplikimi
- Standartet për cilësinë e shërbimit
- Vendimet e bordit, të senatit dhe organeve të tjera drejtuese/vendimmarrëse përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori) (bazuar në vendimin nr 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”).

- Kuotat e parashikuara për çdo vit akademik, të përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori) (bazuar në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”).
- Instrumentet dhe programet e shkëmbimit studentor dhe procedurat përkatëse, përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori) (bazuar në vendimin nr 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”).
- Instrumentet e financimit të studimeve dhe procedurat përkatëse, përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori) (bazuar në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”).
  - o Bursat publike
  - o Bursat specifike për çdo IAL
- Të dhënat për bursat dhe stimujt financiarë të ofruar nga shteti për studentët (bazuar në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”).
- Rezultatet e kontrollit dhe të verifikimit të titujve shkencorë (bazuar në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”).

### **Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP**

- Njoftimi dhe konsultimi publik (Linku)
- Komente/Rekomandime/Opinione të palëve të interesuara/grupe interesi
- Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve
- Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes
- Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP
- Emër mbiemër koordinatori për konsultimin me publikun, adresë postare /elektronike
- Procedurën nëpërmjet së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në cfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të institucionit të arsimit të lartë (bazuar në vendimin nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë”).

### **Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve**

- Lista e dokumenteve që administrohen nga PP me afatet e ruajtjes

### **Rregjistri i kërkesave dhe Përgjigjeve**

- Rregjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve nuk është i përditësuar (sipas Modelit të Rregjistrit të miratuar nga Komisioneri)

### **Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP**

- Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP
- Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve
- Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim
- Procedura e ankimimit

### **Informacion/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun**

- Njoftime të ndryshme
- Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimit në shërbim civil
- Raporte
- Publikime
- Statistika
- Projekte
- Bashkëpunime etj.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pavarësisht se një pjesë e informacionit publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet t'i përmbahet informacionit sipas Programit të Transparencës të Rishikuar miratuar me urdhrin nr.187, datë 18.12.2020, "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar", të ndryshuar, sipas gjetjeve të pasqyruara në lidhjen nr. 1 të këtij rekomandimi.

Lidhur me detyrimet e vendimit nr. 781/2018 të Këshillit të Ministrave "Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë", Zyra e Komisionerit rekomandon ndërlidhjen e këtij informacioni nga programi i transparencës së Autoritetit Publik me linkun <https://u-transparenca.al/>, si dhe përditësimin e tij.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Programi Model i Transparencës përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës së autoriteteve publike dhe çdo autoritet është i detyruar ligjërisht t'a zbatojë atë.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nga monitorimi i kryer,

### **REKOMANDOJ :**

1. Autoriteti Publik, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, në zbatim të gërmave a), b) dhe c), të pikës 2, të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të përditësojë, ndërlidhë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike në përputhje me nenin 7, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Urdhrin nr.187, datë 18.12.2020, "Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar", të ndryshuar, të

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas lidhjes nr. 1 të këtij rekomandimi.

2. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, *“Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me Komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, si dhe e njoftojnë atë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar për kryerjen e tyre”*, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni.
3. Në zbatim të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, pas përfundimit të afatit të mësipërm, Komisioneri do të nisë hetimin administrativ.
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 26.4.2023.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

## Lidhja nr.1

Raport i monitorimit për zbatimin e programit institucional të transparencës, bazuar në Urdhërin nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Infomimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për Autoritetin Publik/ **Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (Rrjeti akademik Shqiptar).**

Prill 2023

Ky raport monitorimi merr në konsideratë vetëm publikimin e informacioneve të cilat janë të ndërlidhura me programin e transparencës sipas Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” si dhe VKM 781/2018 “Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë.

<b>1</b>	<b>Rreth Autoritetit</b>	
	Struktura organizative/Organigrama	jo
	Struktura e pagave	jo
	Funksionet dhe detyrat e AP	jo
	CV-të dhe pagat e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të titullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre dhe procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime.	jo
	VKM. 781/2018 - CV e pedagogëve të përcjellë nga Bordi i Administrimit të institucionit të arsimit të lartë	jo
	Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e RASH ( Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve).	jo
	VKM. 781/2018 - Mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe paraqitjen e ankesave që lidhen me veprimet ose mosveprimet e drejtuesve/organeve drejtuese të institucionit të arsimit të lartë.	
<b>2</b>	<b>Kuadri ligjor rregullator</b>	
	Legjislacion ndërkombëtar	jo
	Legjislacion kombëtar	jo
	Akte nënligjore	jo
	Rregullore	jo
	Kodi i sjelljes	jo
	Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit	jo
	Strategji	jo
	Raport vjetor	jo



	Manuale/dokument politikash, që ka lidhje me funksionet e AP dhe që prek publikun	jo
	VKM 781/2018 -Marrëveshjet dy apo shumëpalëshe në nivel IAL-je dhe institucione të tjera, përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori).	jo
<b>3</b>	<b>E drejta për tu informuar</b>	
	Koordinatori / Emri mbiemri	po
	E-mail	po
	Nr. i gjelbër	jo
	Tel	jo
	Adresa:	po
	Orari:	po
	Format kërkesë / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)	jo
	Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)	jo
<b>4</b>	<b>Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP</b>	
	Rezolute Kuvendi (nese ka)	jo
	Planet strategjike të punës	jo
	Raporte monitorimi/auditimi KLSH	jo
	Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës	jo
<b>5</b>	<b>Informacion mbi buxhetin dhe të dhëna financiare të autoritetit publik</b>	
	Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara (sipas viteve) i RASH	jo
	VKM. 781/2018 – Të dhëna mbi buxhetin afatmesëm (PBA), buxhetin vjetor, grantin nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e tjera, të gjitha shpenzimet operative, shpenzimet për kërkim shkencor dhe shpenzimet kapitale të cdo institucioni publik të arsimit të lartë, përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori).	jo
	Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset (sipas viteve)	jo
	Donacione, sponsorizime (sipas viteve)	jo
	Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara	jo
<b>6</b>	<b>Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncensionit/partneritetit publik privat</b>	

	Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)	jo
	Regjistri i realizimeve të prokurimit publik i RASH	jo
	Informacion mbi monitorimin e kontratave	jo
	Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik i RASH i përditësuar	jo
	VKM 781/2018 – Informacion për procedurat e prokurimit publik (parashikim/realizim) apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori).	jo
<b>7</b>	<b>Shërbimet që ofrohen nga AP</b>	jo
	Tarifat përkatëse	
	Formular aplikimi	jo
	Afati kohor	jo
	Procedura aplikimi	jo
	Standartet për cilësinë e shërbimit	jo
	VKM 781/2018 - Vendimet e bordit, të senatit dhe organeve të tjera drejtuese/vendimmarrëse përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori).	jo
	VKM 781/2018 - Kuotat e parashikuara për çdo vit akademik, të përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori).	jo
	VKM 781/2018 - Instrumentet dhe programet e shkëmbimit studentor dhe procedurat përkatëse, përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori).	jo
	VKM 781/2018 - Instrumentet e financimit të studimeve dhe procedurat përkatëse, përcjellë nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë (Administratori). -Bursat publike, -Bursta specifike për çdo IAL	jo
		jo
	VKM 781/2018 - Të dhënat për bursat dhe stimujt financiarë të ofruar nga shteti për studentët.	jo
	VKM 781/2018 – Rezultatet e kontrollit dhe të verifikimit të titujve shkencorë.	jo
<b>8</b>	<b>Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP</b>	
	Njoftimi dhe konsultimi publik (Linku)	jo

	Komente/Rekomandime/Opinione të palëve të interesuara/grupe interesi	jo
	Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve	jo
	Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes	jo
	Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP	jo
	Emër mbiemër koordinatori për konsultimin me publikun, adresë postare /elektronike	jo
	VKM. 781/2018 – Procedurën nëpërmjet së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në cfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të institucionit të arsimit të lartë.	jo
<b>9</b>	<b>Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve</b>	
	Lista e dokumenteve që administrohen nga PP me afatet e ruajtjes	jo
	Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)	jo
<b>10</b>	<b>Rregjistri i kërkesave dhe Përgjigjeve</b>	
	Regjistri i Kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të Regjistrit të miratuar nga Komisioneri)	jo
	Kërkesat dhe përgjigjet (të linkuara për AP që nuk kanë instaluar portalin Pyet Shtetin/Portali Pyet Shtetin i përditësuar me kërkesat dhe përgjigjet)	jo
<b>11</b>	<b>Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP</b>	
	Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP	jo
	Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve	jo
	Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim	jo
	Procedura e ankimimit	jo
<b>12</b>	<b>Informacion/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun</b>	
	Njoftime të ndryshme	jo
	Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimin në shërbim civil	jo
	Raporte	jo
	Publikime	jo
	Statistika	jo

Projekte	jo
Bashkëpunime etj.	jo

kushtetuese.

- Rreth autoritetit >
- Kuadri ligjor rregullator, Tekstet e plota >
- E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar >
- Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP >
- Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AP >
- Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat >
- Shërbimet që ofrohen nga AP >
- Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nëligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP >

- Mekanizmat kontrollues dhe monitorues qe veprojne mbi AP
- Informacion mbi buxhetin dhe te dhënat financiare të AP
- Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat
- Shërbimet qe ofrohen nga AP
- Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP
- Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve
- Rëgjistri i kërkesave dhe përgjigjeve
- Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AP
- Informacione/dokumente qe kërkohen më shpesh dhe ato qe gjykohen të dobishme për publikim nga AP

e "nepunësit të mirënjohës së të dhënave" (DPO), në intervalin kohor 27-29 janar 2023, për rritjen e njohurive të qytetarëve mbi ushtrimin e kësaj të drejte themelore kushtetuese.

### Rreth autoritetit

- Struktura organizative/Organograma
- Struktura e pagave
- Funkcionet dhe detyrat e A.P
- CV-të dhe pagat e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përfshirë dhe anëtarët e kabinetit të spullarit të AP, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre
- Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime
- Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose masat e AP (Përfshirë adresën postare elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve)

### Kuadri ligjor rregullator, Tekstet e plota

### E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar

**Kuadri ligjor rregullator, Tekstet e plota**

- Legjislacion ndërkombëtar
- Legjislacion kombëtar
- Akte ndëligjore
- Rregullore
- Kodi i shtetit
- Akte që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave të individit
- Strategji
- Raport vjetor
- Matura/dokument politikesh, që ka lidhje me funksionet e AP dhe të prek publikun

**E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar**

**Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP**



E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar

- Koordinator: Z. Rytvan Gjini, Përgjegjës i Burimeve Njerëzore
- E-mail: [administrata@rash.al](mailto:administrata@rash.al)
- Nr. i gjelbër
- Tel
- Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, 1001 Tirane
- Orari zyrtar: E hënë deri të premte 08:00 – 16:30
- Format kërkesë / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)
- Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisionin)

Mekanismat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP

Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AP

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat

E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar >

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP >

- Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë (nëse ka të tillë)
- Planet strategjike të punës
- Raporte monitorimi/auditimi (p.sh. KLSH)
- Dokumenta të tjera që përmbajnë të dhëna të performancës së AP

Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AP >

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat >

Shërbimet që ofrohen nga AP >

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/hënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP >

Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AP

Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AP

- Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në ujtim dhe vitet e ketuesh
- Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset
- Donacione, sponsorizime
- Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara

**Shënim:** Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rreguluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara.

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat

Shërbimet që ofrohen nga AP

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP

Informacion mbi buxhetin dhe te dhenat financiare te AP

Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat

- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktit, datat kontraktuale dhe përshkrimin e shërbimeve)
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik
- Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme

Shërbimet që ofrohen nga AP

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP

Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

**koncesionit/partneritetit publik privat**

**Shërbimet që ofrohen nga AP**

Lista e Shërbimeve\* që ofron AP, përfshirë

- tarifet për akseset (nëse ka)
- formular aplikime
- afat kohor
- procedurë ankimimi
- standardet për cilësinë e shërbimit

Shënim: Lëshim dokumentacioni/Leje/Licenca/Autorizime etj

**Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP**

**Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve**

**Regjistri i kërkesave dhe përafrimeve**

### Shërbimet që ofrohen nga AP

Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nenligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AP

- Njoftimi dhe konsultimi publik (Linku)
- Komente/Rekomandime/Opinjone të palëve të interesuara/grupe interesi
- Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve
- Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmirjes
- Proceduramekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP
- Emri mbiemër të koordinatort për konsultim publik adresë postare/elektronike

### Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

### Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

**Shterimet qe bironen nga AP**

Procedurat/mekanizmat per te dhene mendime lidhur me procesin e hartimit te akteve ligjore/nenligjore, politikave publike apo ne lidhje me ushtrimin e funksioneve te AP

**Sistemi i mbajtjes se dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve**

- Lloje e dokumenteve qe administrohen nga AP me efektivitet te rruajtjes
- Formen e dokumenteve/informacioneve te elektronik (kopje fizike, audio, video, foto)

**Regjistri i kerkesave dhe pergjigjeve**

**Ndihma shoqerore/subvencione te dhena nga AP**

**Informacione/dokumente qe kerkohej me shpesh dhe ato qe gjykohen te dobishme per publikim nga AP**

- Cilët jomë
- Historikë
- Bordi Drejtues
- Asambleja e Anetarëve
- Legjislacion
- Programi i transparencës
- Partneret

### Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Stadiumi i përfundimit të kërkesës	Tarifë
1	06.01.2022	Info mbi zbatimin e strategjisë për shkencën	26.01.2022	Kërkesit i është vënë në dispozicion informacioni me shkresë zyrtare nr.06/1 prot. Datë 26.01.2022	E plotë	Pa pagesë
2	30.03.2022	Info mbi projektet me financim të huaj	08.04.2022	Është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar me email dhe shkresë zyrtare nr.174/1 prot	E plotë	Pa pagesë
3	07.11.2022	Info mbi statistikat e regjistrimeve në U- Albania	18.11.2022	Kërkesit i është vënë në dispozicion informacioni nëpërmjet email në respektim të akteve nënligjore mbi përfundimin e afatit të regjistrimeve deri në dërgimin e listës zyrtare.	E kufizuar	Pa pagesë



RE AP

**Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve**

**Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve**

**Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AP**

- Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga AP
- Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve
- Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencioneve dhe dokumentacioni përkatës për aplikim
- Procedura e ankimit
- Kërkesat dhe përgjigjet (të linkuar për AP që nuk kanë instaluar portalin Pyet Shtetin/Portali Pyet Shtetin i përditësuar me kërkesat dhe përgjigjet

**Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga AP**


Activate Windows  
Go to Settings to activate Windows.

## Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AP

Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga AP

- Njoftime të ndryshme
- Njoftime për procedurat e rekrutimit/parimit në shërbim civil
- Raporte
- Publikime
- Statistikë
- Projekte
- Bashkëpunime etj.

Shënim: AP vlerëson publikimin duke patur parasysh kërkesat që meren më shpesh.



## Njoftime për fitues

Home / Njoftime për fitues

### Njoftim fituesish i datës 21 Mars 2023

Bazuar në njoftimin e AKAFPK-së të datës 13 mars 2023 për specialistë të jashtëm për hartimin e Standardeve të Profesioneve, komisioni bëri vlerësimin e kandidatëve që konkuruan mbi bazën e dosjeve, si specialistë të jashtëm me kontratë .

→ më shumë

Njoftim fituesish i datës 10 Mars 2023 për bashkëpunëtorë të jashtëm për hartimin e standardeve të kualifikimeve profesionale

Bazuar në njoftimin e AKAFPK-së të datës 27 Shkurt 2023 për bashkëpunëtorë të jashtëm për rishikimin e standardeve të kualifikimeve profesionale "Ndërtim" nivel IV në KSHK, komisioni bëri vlerësimin e kandidatëve që konkuruan mbi...

→ më shumë

Njoftim fituesish i datës 20 shkurt 2023 për specialistë të jashtëm për hartimin e Standardeve të Profesioneve

Bazuar në njoftimin e AKAFPK-së të datës 14 Shkurt 2023 për specialistë të jashtëm për hartimin e Standardeve të Profesioneve, komisioni bëri vlerësimin e kandidatëve që konkuruan mbi bazën e dosjeve, si specialistë të jashtëm me kontratë.

→ më shumë

Njoftim për fitues i datës 17 shkurt 2023 për bashkëpunëtorë për hartimin e kursit të trajnimit "Bazat e didaktikës në Arsimin dhe Formimin Profesional 2023"

Bazuar në njoftimin e AKAFPK-së të datës 2 shkurt 2023 "Për trajnerë të kursit të trajnimit "Bazat e didaktikës në Arsimin dhe Formimin Profesional", komisioni bëri vlerësimin e kandidatëve që konkuruan mbi bazën e dosjeve, si specia...

→ më shumë